



**Organizata e Kombeve të Bashkuara
për Arsim, Shkencë dhe Kulturë**

**UDHEZIME
PER SIGURIMIN E CILESISE
NE ARSIMIN E LARTE
NDERKUFITAR**

Paris, 2005

Për më tepër informacion:

Përgjegjës i Seksionit për Reformim, Risi dhe Sigurimin e Cilësisë
Seksioni i Arsimit të Lartë
UNESCO

7. Place de Fontenoy
75352 Paris 07 SP
Francë

Tel: 33 1 45680832

E-mail: guidelines-qa@unesco.org

Internet: [http:// www.unesco.org/education/hed/guidelines](http://www.unesco.org/education/hed/guidelines)

Publikuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara
për Arsim, Shkencë dhe Kulturë

Përgatitur dhe printuar në workshop-et e UNESCO

@ UNESCO 2005

Printuar në Francë

(ED-2005/WS/76)

SHENIM NGA SEKRETARIATI

Iniciativa për hartimin e dokumentit "Udhëzime për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë Ndërkufitar" është një proces vazhdues i rezolutës së adoptuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO (29 shtator-17 Tetor 2003) e cila ngarkon Drejtorinë e Përgjithshme për "të zhvilluar praktika dhe parime për parashikimin e masave ndërkufitare në Arsimin e Lartë, mbështetur në kompetencat e UNESCO-s dhe agjencive të tjera Ndërkombëtare, në bashkëpunim me Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë dhe ofuesit e arsimit të lartë.

Rezoluta konfirmoi rolin drejtues të UNESCO në Arsimin e Lartë, të rishpallur në Konferencën Botërore të Arsimit të Lartë (WCHE, 1998, WCHE+5, 2003), dhe Forumin Global për Sigurimin Ndërkombëtar të Cilësisë, Akreditimin dhe Njohjen e Kualifikimeve (2002 – 2004).

UNESCO dhe OECD (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Demokratik) ranë dakort të vazhdonin me përpunimin e Udhëzimeve të përbashkëta për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë Ndërkufitar, bazuar në parimet dhe Instrumentet e Kombeve të Bashkuara, si një përgjigje e arsimit ndaj komercializimit në rritje të Arsimit të Lartë.

Qëllimi i procesit të hartimit ishte përpunimi i udhëzimeve mbështetur në nevojat specifike të shteteve antare (Member States) dhe adresimi i problemeve reale në këtë drejtim. Në këtë proces, u ftuan të merrnin pjesë, ekspertë të UNESCO-s, OECD-së, shteteve anëtare të OECD-së, si edhe aktorë të tjerë kyç, si IAL-të, shoqatat e studentëve, Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë dhe të Akreditimit, Agjencitë e njohura/miratuara, shoqatat e stafeve akademike, grupet profesionale, sektori privat dhe organizata të tjera ndërkombëtare, këto udhëzime u konceptuan si vullnetare dhe jo-detyruese; ato synojnë të shërbejnë si orientim për zhvillimin e kapaciteteve kombëtare dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë hapësirë. Ky nuk është një dokument detyrues e as vendosës i standardeve.

Qëllimi i Udhëzimeve është të propozojë instrumente dhe një përmbledhje të praktikave më të mira që mund të ndihmojnë Shtetet anëtare në procesin e vlerësimit dhe të sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë Ndërkufitar dhe të mbrojnë studentët dhe aktorët e tjerë kryesorë në AL nga cilësia e ulët në këtë sektor.

Udhëzimet i adresohen 6 aktorëve kryesorë në Arsimin e Lartë: qeverive, Institucionet e Arsimit të Lartë/ofruesit duke përfshirë stafin akademik, grupet studentore, institucionet e akreditimit dhe të sigurimit të cilësisë, institucionet përgjegjëse për njohjen akademike dhe grupet profesionale; ato sigurojnë një tërësi orientimesh edhe për

praktikantët, dhe përpiqen të promovojnë besimin e ndërsjelltë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar midis siguruesve dhe ofruesve të Arsimit të Lartë Ndërkufitar.

Në zbatim të Rezolutës së 33-të të Konferencës së Përgjithshme (tetor 2005), udhëzimet nxirren si një dokument i sekretariatit mbi: "Sigurimi i Cilësisë në Arsimin e Lartë Ndërkufitar" i përpunuar në bashkëpunim me OECD. Ato duhet të kuptohen si një dokument në kohë e që i adresohet çështjeve kyç të AL në një shoqëri më të globalizuar; ato duhet të kuptohen njësoj të lidhura si me vendet e zhvilluara, ashtu dhe ato në zhvillim e sipër.

Ndërkohë UNESCO është i gatshëm të sigurojë sipas kërkesës, këshilla për shtetet anëtare dhe partnerët lidhur me atë se si Udhëzimet mund të përdoren e shfrytëzohen më mirë: për të promovuar aftësitë për të ndërtuar Sigurimin e Cilësisë në nivel rajonal, duke përdorur si referencë kwtu Udhëzime dhe konventa rajonale per njohjen e kualifikimeve si skema ekzistuese.

Georges Haddad

Drejtor

Sektori i Arsimit të Lartë

Falenderimet

Prezantimi

Qëllimi i Udhëzimeve

Nevoja për Udhëzimet

Sfera e Udhëzimeve

Udhëzime për Aktorët kyç të Arsimit të Lartë

Udhëzime për qeveritë

Udhëzime për Institucionet/ Ofruesit e Arsimit të Lartë

Udhëzime për Trupat Studentore

Udhëzime për Institucionet /Trupat e Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit

Udhëzime për Institucionet /Trupat e Njohjes Akademike

Udhëzime për Trupat/Grupet Profesionale

Personat më poshtë falenderohen ngrohtësisht për kontributin e tyre në përpunimin e Udhëzimeve:

OECD

Bernard Hugonnier, Drejtor, Drejtoria për Arsimin

Keiko Momii, Analist, Qendra për Kërkime dhe Risi në Arsim (CERI)

Kurt Larsen, ish - krye/analist, Qendra për Kërkime dhe Risi në Arsim (CERI)

Stéphan Vincent-Lancrin, Analist, Qendra për Kërkime dhe Risi në Arsim (CERI)

UNESCO

Seksioni për Reforma, Rinovim dhe Sigurimin e Cilësisë

Stamenka Uvalić-Trumbić, Shef i Seksionit

Zeynep Varoglu, Specialist Asistent i Programit

Ranëa Safadi, Specialist i Programit

Tove Lyngra, Specialist i Programit

Liliana Simionescu, Specialist Asistent i Programit

Yoshie Ishida, ekspert koleg

Jennifer Lim-Dajczman, Asistent i Shefit të Seksionit

Sandrine Baron, Asistent i Sekretariatit

Kompozimi

Dominique Lim

Mirian Quérol

**PER SIGURIMIN E CILESISE
NE ARSIMIN E LARTE
NDERKUFITAR**

I. PREZANTIM

Qëllimi i Udhëzimeve

Qëllimi i Udhëzimeve për të mbështetur dhe inkurajuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe për të përmirësuar të kuptuarin e rëndësisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë Ndërkufitar.² Qëllimet e Udhëzimeve janë për të mbrojtur studentët dhe aktorët e tjerë kyç nga Cilësia e Dobët dhe Siguruesit e dyshimtë³ si dhe të inkurajojë zhvillimin e Arsimit të Lartë Ndërkufitar cilësor që plotëson nevojat njerëzore, shoqërore, ekonomike dhe kulturore.

¹ **Këto Udhëzime nuk janë të detyrueshme ligjërisht dhe Shtetet Anëtare pritet të implementojnë Udhëzimet në përshtatshmëri me kontekstin e tyre kombëtar.**

² **Në këto Udhëzime, Arsimi i Lartë Ndërkufitar përfshin Arsimin e Lartë në kushtet ku rastet kur mësimdhënësit, studentët, programet, institucionet/orfruesit ose materialet e kursit kapërcejnë kufijtë kombëtarë të juridiksionit. Arsimi i Lartë Ndërkufitar mund të përfshijë Arsimin e Lartë publik ose privat dhe siguruesit përfitues ose jopërfitues. Ai qarkon një gamë të gjerë modalitetesh, duke nisur nga mësimi në institucion (në forma të ndryshme si psh studentët që udhëtojnë jashtë dhe campus-et jashtë shtetit) deri tek ai në distancë (duke përdorur një gamë teknologjish dhe duke përfshirë këtu edhe e-learning).**

³ **Në këtë kontekst 'sigurues i dyshimtë' nënkupton "mullinjtë e prodhimit të diplomave dhe akreditimeve të paligjshme" (shënim i Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë: në shqip kjo nënkupton institucione të arsimit të lartë apo institucione të akreditimit që operojnë në mënyre të dyshimtë dhe të panjohur nga organet kompetente, dhe cilësia e të cilave është e pavërtetuar/e paçertifikuar)**

Nevoja për Udhëzimet

Që nga vitet 1980, Arsimi i Lartë Ndërkufitar, është zhvilluar dhe rritur në mënyrë të konsiderueshme përmes mobilitetit të studentëve, stafit akademik, programeve/institucioneve dhe profesionistëve. Paralelisht me këtë, janë shfaqur mënyra të reja shpërndarjeje dhe siguries ndërkufitare të tillë si campus-et e jashtëm, shpërndarja elektronike e Arsimit të Lartë dhe siguriesve jopërfitues. Këto forma të reja të ofertës së Arsimit të Lartë Ndërkufitar rritën mundësitë për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave individuale të studentëve dhe cilësisë së Sistemeve Kombëtare të Arsimit të Lartë, duke ju siguruar atyre mundësi për të përfituar nga zhvillimi njerëzor, shoqëror, ekonomik dhe kulturor i vendeve pritëse.

Ndërsa në disa vende struktura kombëtare për Sigurimin e Cilësisë, akreditimin dhe njohjen e kualifikimeve, marrin parasysh Arsimin e Lartë Ndërkufitar, në shumë vende të tjera ato akoma nuk janë të pajisura e të përgatitura për të adresuar sfidat për masat ndërkufitare. Për më tepër, mungesa e strukturave të plota për iniciativa të ndryshme koordinuese në nivel ndërkombëtar, së bashku me larminë dhe pabarazinë e Sistemeve të Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit në nivel kombëtar, krijon boshllëqe dhe mospërputhje në sigurimin e cilësisë të Arsimit të Lartë Ndërkufitar, duke lënë aspekte apo fusha të Arsimit të Lartë Ndërkufitar jashtë strukturave të Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit. Kjo i bën studentët dhe aktorët e tjerë kyç më të prekshëm ndaj siguriesve⁴ të parespektueshëm dhe masave të cilësisë së ulët. Sfida që përballojnë sistemet e Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit është të zhvillojë procedurat dhe sistemet e duhura për të mbuluar edhe siguriesit dhe programet e huaja (psh përveç siguriesve dhe programeve kombëtarë), me qëllim që të rritë përfitimet dhe të kufizojë pengesat e dizavantazhet e mundshme të ndërkombëtarizimit të Arsimit të Lartë. Në të njëjtën kohë, rritja e lëvizjes së studentëve ndërkufitarë, stafit akademik, kërkuesve dhe profesionistëve ka vënë në diskutim njohjen e kualifikimeve akademike dhe profesionale në axhendën e një bashkëpunimi ndërkombëtar.

Pra ka një nevojë për iniciativa ndërkombëtare shtesë, bashkëpunim ndërkombëtar të përforcuar dhe punë në rrjet, dhe më tepër informacion transparent mbi procedurat dhe sistemet e sigurimit të cilësisë, akreditimit dhe njohjes së kualifikimeve. Këto përpjekje duhet të kenë shkallë globale dhe duhet të theksohen duke mbështetur nevojat për zhvillimin dhe stabilizimin e sistemeve të fuqishme të Arsimit të Lartë në këto vende. Duke qenë

⁴ Shih shenimin 3

se disa vende kanë nevojë për skema të plota e gjithëpërfshirëse për SC-Sigurimin e Cilësisë, akreditimi dhe njohjen e kualifikimeve, aftësia për të ngritur e zhvilluar këtë sistem duhet të përbëjë një pjesë të rëndësishme të punës, duke forcuar dhe koordinuar iniciativat kombëtare dhe ndërkombëtare në këtë drejtim.

Në këtë dritëvështrim, sekretariati i UNESCO-s dhe OECD-së kanë bshkëpunuar në përputhje e së bashku për hartimin e udhëzimeve për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë Ndërkufitar. Vënia në jetë e këtyre udhëzimeve mund të shërbejë si një hap i parë në procesin e ngritje së këtyre sistemeve.

Cilësia e sektorit të Arsimit të Lartë të një vendi, vlerësimi dhe monitorimi i tij, është jo vetëm çelësi për mirëqënien, por gjithashtu faktor vendimtar që prek statusin e sistemeve të Arsimit të Lartë në nivel ndërkombëtar. Themelimi dhe zhvillimi i sistemeve të Sigurimit të Cilësisë është bërë një domosdoshmëri, jo vetëm për monitorimin e cilësisë në Arsimin e Lartë që ofrohet brenda vendit, por gjithashtu për angazhimin në ofertën e Arsimit të Lartë ndërkombëtar. Si pasojë, ka patur një rritje impresionuese në numrin e institucioneve të SC dhe Akreditimit për Arsimin e Lartë në dy dekadat e fundit. Megjithatë, kapacitetet ekzistuese kombëtare të Sigurimit të Cilësisë shpesh fokusohen vetëm në ofertën AL të brendshëm nga institucionet e brendshme të AL.

Rritja ndërkufitare e lëvizjes së studentëve, stafit akademik, profesionistëve, programeve dhe siguruesve paraqesin sfida për strukturat dhe institucionet ekzistuese kombëtare të Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit si dhe për sistemet e njohjes së kualifikimeve të huaja. Disa nga këto sfida janë përshkruar si më poshtë:

- (a) Kompetenca kombëtare për Sigurimin e Cilësis dhe Akreditimin shpesh nuk mbulon Arsimin e Lartë Ndërkufitar. Kjo e rrit rrezikun që studentët të bien viktima të një drejtimi dhe informimi çorientues/mashtrues dhe siguruesish të pandershëm/të parespektuar, grupesh të dyshimta të Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit dhe masave të një cilësie të ulët, të cilat çojnë në kualifikime të dyshimta për nga vlefshmëria e tyre.
- (b) Sistemet dhe Grupet Kombëtare për njohjen e kualifikimeve mund të kenë njohuri dhe përvojë të kufizuar në trajtimin e Arsimit të Lartë Ndërkufitar. Në disa raste, sfida bëhet më e ndërlikuar ndërsa një Arsim i Lartë Ndërkufitar mund të prodhojë kualifikime që nuk janë cilësisht të krahasueshme me ato të cilat ato ofrojnë në vendet e tyre.

- (c) Nevoja në rritje për njohje kombëtare të kualifikimeve të huaja përbën një sfidë për Trupat Kombëtarë të Njohjes së Kualifikimeve. Në këtë mënyrë akumulohen në probleme administrative dhe ligjore për personat e përfshirë e të interesuar;
- (d) Profesionistët varen nga kualifikimet e besueshme e me cilësi të lartë. Është thelbësore që përdoruesit e shërbimeve profesionale duke përfshirë edhe punëdhënësit, të kenë besim të plotë në aftësitë e profesionistëve të kualifikuar. Mundësia në rritje e kualifikimeve të fituara me cilësi të ulët mund të dëmtojnë vetë profesionistët dhe mund të minojnë gjatë rrugës besimin në kualifikimet profesionale.

Sfera e Udhëzimeve

Udhëzimet synojnë të sigurojnë një strukturë ndërkombëtare për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë Ndërkufitar që i përgjigjet sfidave të përmendura më lart.

Udhëzimet janë të bazuara mbi parimet e besimit dhe respektit reciprok midis vendeve dhe mbi njohjen e rëndësisë së bashkëpunimit ndërkombëtar në Arsimin e Lartë. Ato gjithashtu marrin parasysh dhe njohin rëndësinë e autoriteteve kombëtare dhe larmisë së sistemeve të Arsimit të Lartë. Vendet i japin një rëndësi të madhe sovranitetit kombëtar mbi Arsimin e Lartë. Arsimi i Lartë është një mjet thelbësor për shprehjen e larmisë gjuhësore dhe kulturore të një vendi dhe gjithashtu për të ushqyer e nxitur rritjen e zhvillimit ekonomik dhe kohezionin e tij shoqëror.

Efektshmëria e Udhëzimeve varet kryesisht nga mundësia e fuqizimit dhe përmirësimit të kapaciteteve të sistemeve kombëtare për të siguruar cilësi në Arsimin e Lartë. Zhvillimi dhe vënia në jetë e konventave rajonale të UNESCO-s dhe mbështetja e mëtejshme për iniciativat e ndërtimit të kapaciteteve në vazhdimësi të UNESCO-s, në këtë hapësirë do të mbështetin dhe do të jenë plotësues të Udhëzimeve edhe organizata të tjera të shumanshme dhe kontribues të dyanshëm. Këto iniciativa duhet të mbështeten edhe nga partnerë të fuqishëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Arsimi i Lartë Ndërkufitar njihet rolin e rëndësishëm të organizatave jo-qeveritare të tilla si: Shoqatat e Arsimit të Lartë, grupet studentore, shoqatat e stafeve akademike, rrjetet e institucioneve për sigurimin e cilësisë dhe akreditim, grupet e vlerësimit dhe të njohjes për përforsimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë Ndërkufitar. Udhëzimet synojnë të inkurajojnë forcimin dhe koordinimin e iniciativave ekzistuese përmes nxitjes së dialogut dhe bashkëpunimit midis trupave të ndryshme.

Arsimi i Lartë Ndërkufitar qarkon një radhë të gjerë mënyrash arsimimi, që nga mësimi ballë për ballë (i cili merr forma të ndryshme si psh: studentët që udhëtojnë jashtë dhe kampuset jashtë vendit) deri në atë në distancë (duke përdorur një radhë teknologjish përfshirë këtu edhe e-learning). Gjatë vënies në jetë të Udhëzimeve duhet të kihet në konsideratë e duhet t'i jepet rëndësi larmisë së formave të arsimit dhe kërkesave të tij të ndryshme për Sigurimin e Cilësisë.

II. UDHEZIME PER AKTORET KYÇ TE ARSIMIT TE LARTE

Në respekt të ndarjes së përgjegjësive për AL, që janë specifike për çdo vend, Udhëzimet rekomandojnë veprime për 6 aktorët kryesorë⁵: qeveritë, Institucionet e Arsimit të Lartë-të/ofruesit, përfshirë stafin akademik, grupet studentore, trupat e Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit, trupat për njohjen akademike⁶ dhe ato profesionale.

UDHEZIME PER QEVERITE

Qeveritë mund të jenë ndikuese, nëse jo përgjegjëse, në promovimin e sistemeve të përshtatshme për sigurimin e cilësisë, akreditimin dhe njohjen e kualifikimeve. Ato kanë rolin e hartimit të politikave bashkërenduese në shumicën e sistemeve të Arsimit të Lartë. Megjithatë, në këto udhëzime pranohet se, në disa vende, autoriteti për mbikqyrjen e Sigurimit të Cilësisë shtrihet në grupet qeveritare kombëtare ose në organizatat jo-qeveritare.

Në këtë kontekst, rekomandohet që qeveritë:

- (a) të themelojnë, ose të inkurajojnë themelimin e një sistemi transparent, të drejtë, të përshtatshëm për regjistrimin ose liçensimin për ofruesit e AL Ndërkufitar, të cilët dëshirojnë të veprojnë në territorin e tyre.
- (b) Të krijojnë ose të inkurajojnë ngritjen e kapaciteteve të përshtatshme për sigurimin e besueshëm të cilësisë dhe akreditimin e Arsimit të Lartë Ndërkufitar, duke pranuar që SC dhe akreditimi i Arsimit të Lartë Ndërkufitar përfshin si vendet dërguese ashtu dhe ato pritëse
- (c) Të konsultohen dhe të koordinohen midis grupeve të ndryshme kompetente për SC dhe akreditimin si në plan kombëtar ashtu dhe në atë ndërkombëtar.
- (d) Të sigurojnë informacion të saktë, të besueshëm dhe lehtësisht të arritshëm, sipas kriterëve dhe standardeve për regjistrimin, liçensimin, Sigurimin e Cilësisë e Akreditimin e Arsimit të Lartë Ndërkufitar, pasojat e tyre mbi studentët, institucionet ose programet dhe, ku është e mundur, natyra e tyre vullnetare ose e detyrueshme;
- (e) Të konsiderohet pjesëmarrja dhe kontributi në zhvillimin dhe/ose zbatimin e konventave rajonale të përshtatshme të UNESCO mbi njohjen e kualifikimeve dhe

themelimin e qendrave kombëtare të informacionit ashtu siç përcaktohen në konventë;

- (f) Aty ku është e përshtatshme, të zhvillohen ose inkurajohen hartimi i marrëveshjeve për njohje dypalëshe e shumëpalëshe, duke lehtësuar njohjen ose ekuivalentimin e kualifikimeve të çdo vendi të bazuara në procedura dhe kritere të parashikuara në marrëveshjet e ndërsjellta;
- (g) Të kontribuojnë në përpjekjet për të përmirësuar hapjen në nivel ndërkombëtar dhe akses ndaj një informacioni të saktë dhe të plotë për Institucionet/ofruesit e Arsimit të Lartë në këtë plan.

⁵ Në Udhëzime, dallimet midis këtyre aktorëve kryesorë bëhen bazuar në funksionet që ato kanë, duke pranuar se funksionet e ndryshme nuk i përkasin detyrimisht grupeve të veçantë.

⁶ Trupat e njohjes akademike përfshijnë Trupat për Njohjen e Kualifikimeve, Grupet për vlerësimet kredenciale dhe Qendrat këshillimore ose të Informacionit.

UDHEZIME PER INSTITUCIONET/OFRUESIT E ARSIMIT TE LARTE

Angazhimi për cilësi nga të gjithë Institucionet/Ofruesit e Arsimit të Lartë është thelbësor⁷. Për këtë qëllim janë të domosdoshme kontributet aktive dhe dobiprurëse të stafit akademik. Institucionet e Arsimit të Lartë janë përgjegjëse për cilësinë si dhe për lidhjet shoqerore, kulturore dhe gjuhësore të edukimit, si dhe standardet e kualifikimeve të siguruara në emrin e tyre, pavarësisht nga fakti se në ç`formë ai ofrohet.

Në këtë kontekst, rekomandohet që Institucionet/Ofruesit e Arsimit të Lartë që ofrojnë AL Ndërkufitar:

- (a) të sigurohen që programet e tyre përtej kufijve dhe në vendin e tyre të jenë cilësisht të krahasueshme dhe ato marrin parasysh gjithashtu ndjeshmërinë kulturore dhe gjuhësore të vendit pritës. Dëshirohet që një angazhim i tillë të bëhet publik;
- (b) të njohin që cilësia e mësimdhënies dhe kërkimit, ka në bazë cilësinë e fakultetit dhe cilësinë e kushteve të tyre të punës, që nxisin e zhvillojnë kërkime të pavarura dhe kritike. Për të mbështetur kushtet e mira të punës dhe të shërbimit, qeverisjen kolegjiale dhe lirinë akademike, nevojitet të merret parasysh nga të gjitha institucionet dhe ofruesit rekomandimet e UNESCO në lidhje me statusin e Personelit mësimdhënës të Arsimit të Lartë⁸ dhe instrumenta të tjerë të lidhur me to;
- (c) të zhvillojnë e të mbajnë ose të rishikojnë sistemet e tashme të menaxhimit të cilësisë, që të mund të përdorin kështu plotësisht, kompetencat e aktorëve kyç të tillë si: stafi akademik, administratorët, studentët dhe të diplomuarit dhe të mbajnë përgjegjësi të plotë për ofrimin e kualifikimeve të Arsimit të Lartë të krahasueshme me standardet në vendet e tyre dhe përtej kufijve. Për më tepër, kur promovojnë programet e tyre për studentët përmes përfaqësuesve të tyre, ata duhet të marrin përgjegjësi të plotë për të siguruar që informacioni dhe udhëheqja e siguruar nga këta të fundit të jetë i sakte, i besueshëm dhe lehtësisht i arritshëm;
- (d) Të konsultojnë grupet kompetente të Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit dhe të respektojnë sistemet e Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit të vendeve pritëse kur ofrojnë Arsimin e Lartë Ndërkufitar, duke përfshirë këtu edhe arsimimin në distancë.
- (e) Të ndajnë praktikat më të mira duke marrë pjesë në organizata sektoriale dhe rrjete ndërinstitucionale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

- (f) Të zhvillojnë dhe të mbajnë rrjetëzim dhe partneritet për të lehtësuar procesin e njohjes përmes pranimit të kualifikimeve të njëri-tjetrit si ekuivalente ose të krahasueshme;
- (g) Kur është e rëndësishme, të përdorin kodet e praktikës së mirë të tilla si: UNESCO/Këshilli i Evropës "Kodi i Praktikës së mirë për arsimin transkombëtar"⁹ dhe kode të tjera të rëndësishme si Këshilli i Evropës/UNESCO "Rekomandime për Kriteret dhe procedurat për vlerësimin e Kualifikimeve të huaja"¹⁰;
- (h) Të sigurojnë informacion të saktë, të besueshëm dhe lehtësisht të arritshëm mbi kriteret dhe procedurat e Sigurimit të Brendshëm dhe të Jashtëm të Cilësisë dhe njohjes akademike e profesionale të kualifikimeve që ata ofrojnë dhe të sigurojnë përshkrime të programeve dhe kualifikimeve, duke preferuar ato me përshkrime të njohurive, të të kuptuarit dhe aftësive që një student i suksesshëm duhet të përftojë. IAL-të/ofruesit duhet të bashkëpunojnë veçanërisht me grupet e SC dhe akreditimit dhe organizatat studentore, për të lehtësuar përhapjen e këtij informacioni;
- (i) Të sigurojnë transparencën e statusit financiar të institucionit dhe/ose programeve të arsimit të ofruara.

⁷ Një nismë e rëndësishme për këtë është formulimi "Ofrimi i Arsimit të Lartë Ndërkufitar Cilësor" nga Shoqata Ndërkombëtare e Universiteteve, Shoqata e Universiteteve dhe Kolegjeve të Kanadasë, Këshilli Amerikan për Arsimin dhe Këshilli për Akreditimin e Arsimit të Lartë në emër të institucioneve të Arsimit të Lartë kudo në botë

⁸I disponueshëm në: http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=13144&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201

⁹ I disponueshëm në: <http://www.cepes.ro/hed/recogn/groups/transnat/code.htm>

¹⁰I disponueshëm në: http://www.coe.int/T/DG4/HigherEducation/Recognition/Criteria%20and%20procedures_EN.asp#TopOfPage

UDHEZIME PER TRUPAT STUDENTORE

Si përfaqësues të përfituesve të drejtpërdrejtë të Arsimit të Lartë Ndërkufitar dhe si pjesë e komunitetit të Arsimit të Lartë, Trupat Studentore mbajnë përgjegjësi për ndihmën ndaj studentëve dhe studentëve të mundshëm, duke shqyrtuar me kujdes informacionin në dispozicion dhe ta marrin seriozisht në konsideratë në procesin e vendimmarrjes.

Në këtë kontekst, rekomandohet që të inkurajohet shfaqja e grupeve studentore lokale, kombëtare apo ndërkombëtare autonome dhe që grupet apo organizimet studentore:

- (a) të përfshihen si partnerë aktivë në nivel kombëtar, ndërkombëtar dhe institucional për zhvillimin, monitorimin dhe ofrimin e masave me cilësi të Arsimit të Lartë Ndërkufitar, si dhe të bëjnë hapat e nevojshëm për të arritur këto objektiva.
- (b) Të marrin pjesë aktive në promovimin e masave të cilësisë, duke rritur vetëdijen e studentëve për rreziqet e mundshme të tilla si: keqorientimi, ofrimi i një cilësie të ulët e cila çon në kualifikime të kufizuara për nga vlefshmëria dhe ofrues të dyshimtë. Ato duhet gjithashtu ti drejtojnë ata drejt burimeve të informacioneve të sakta dhe të besueshme të Arsimit të Lartë Ndërkufitar. Kjo mund të bëhet duke rritur vetëdijen e ekzistencës së këtyre Udhëzimeve si edhe marrja pjesë aktive për vënien e tyre në jetë;
- (c) Të inkurajojnë studentët dhe studentët potencialë që të bëjnë pyetje e të paraqesin kërkesat e duhura kur pranohen në programet e Arsimit të Lartë Ndërkufitar. Një listë pyetjesh të lidhura me to mund të hartohet nga grupet studentore, duke përfshirë studentët e huaj kur është e mundur, dhe në

bashkëpunim me grupe të tilla si: IAL-të, grupet për Sigurimin e Cilësisë dhe Akreditim dhe trupat për njohjen akademike. Një listë e tillë duhet të përfshijë pyetjet si më poshtë: nëse institucionet e huaja/ofruesit janë të njohur ose akredituar nga një institucion i besueshëm dhe nëse kualifikimet e ofruara njihen në vendin e studentëve për qëllime akademike dhe/ose profesionale.

UDHËZIME PËR INSTITUCIONET/TRUPAT E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

Përveç menaxhimit të brendshëm të cilësisë nga ana e institucioneve/ofruesve, sistemet e sigurimit të jashtëm janë dhe operojnë në më tepër se 60 vende. Institucionet e Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit janë përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë në Arsimin e Lartë. Sistemet ekzistuese të Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit shpesh variojnë nga një vend në tjetrin dhe ndonjëherë edhe vetë brenda një vendi. Për më tej egzistojnë edhe ndryshime në terminologjinë e përdorur, në përkufizimin e 'cilësisë', në qëllimin dhe funksionimin e sistemit duke përfshirë lidhjen e tij me financimin e studentëve, institucioneve ose programeve, metodologjive të përdorura në sigurimin e cilësisë dhe akreditimin, qëllimin dhe funksionimin e njësisë apo grupit përgjegjës, dhe natyrën vullnetare ose të detyrueshme të pjesëmarrjes. Ndërsa respekton këtë diversitet, nevojiten përpjekje të koordinuara midis grupeve të vendeve dërguese dhe pritëse, si në nivelet rajonale ashtu dhe globale, për të përballuar sfidat që dalin nga rritja dhe zgjerimi i Arsimit të Lartë Ndërkufitar, sidomos në format e tij të reja.¹¹

Në këtë kontekst, rekomandohet që Institucionet e Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit:

- (a) Të sigurohen se rregullimet për sigurimin e cilësisë dhe akreditimit përfishijnë edhe Arsimin e Lartë Ndërkufitar në format e ndryshme të tij. Kjo do të thotë t'i kushtosh vëmendje udhëzimeve për vlerësimin e tij, duke siguruar që standardet dhe proceset janë transparente, konsekuente dhe të përshtatshme, duke marrë parasysh formën dhe qëllimin e sistemit kombëtar të Arsimit të Lartë, dhe përshtatjen me ndryshimet e zhvillimet në arsimin ndërkufitar;
- (b) Të mbështetin dhe të forcojnë rrjetet ekzistuese rajonale dhe ndërkombëtare ose të vendosin rrjete të tilla në rajone të cilat nuk e kanë një të tillë. Këto rrjete mund të shërbejnë si platforma për të shkëmbyer informacion dhe praktikën e mirë, të përhapin njohuri, të rritin mirëkuptimin e zhvillimeve dhe sfidave ndërkombëtare, si dhe të përmirësojnë ekspertizën profesionale të stafit të tyre dhe vlerësuesve të cilësisë. Këto rrjete gjithashtu mund të përdoren për të ngritur ndërgjegjen e ofruesve të pandershëm dhe grupeve të dyshimta të Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit, dhe të zhvillojnë sistemet e monitorimit dhe raportimit që mund të çojnë në identifikimin e tyre.

¹¹ Shiko shënimin 2

- (c) Të krijojnë lidhje për të forcuar bashkëpunimin midis grupeve të vendeve dërguese dhe pritëse dhe për të rritur mirëkuptimin e dyanshëm të sistemeve të ndryshme të sigurimit të cilësisë dhe akreditimit. Kjo mund të lehtësojë procesin e sigurimit të cilësisë së programeve të ofruara përtej kufijve dhe institucioneve që veprojnë përtej kufijve, ndërkohë që respektojnë sistemet e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit të vendeve pritëse.
- (d) Të sigurojnë informacion të saktë dhe lehtësisht të arritshëm mbi standardet, procedurat e vlerësimit dhe efektet e mekanizmave të Sigurimit të Cilësisë për financimin e studentëve, institucionet ose programet, atje ku kjo është e mundur edhe rezultatet e vlerësimeve. Institucionet e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit duhet të bashkëpunojnë me aktorët e tjerë, veçanërisht Institucionet e Arsimit të Lartë/ofruesit, stafin akademik, grupet studentore dhe grupet për njohjen akademike për të lehtësuar përhapjen e informacioneve të tilla;
- (e) Të aplikojnë parimet e reflektuara në dokumentat ndërkombëtare mbi Arsimin e Lartë Ndërkufitar të tilla si: UNESCO/Këshilli i Evropës 'Kodi i Praktikës së Mirë për Arsimin e Lartë Ndërkufitar'.¹²
- (f) Të arrijnë marrëveshje për njohje reciproke me grupet e tjerë mbi baza besimi dhe mirëkuptimi të praktikës profesionale të njëri-tjetrit, të zhvillojnë sistemet e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e vlerësimeve të jashtme të kaluara, duke përdorur plotësisht kompetencat e aktorëve kyç.
- (g) Të parashikohen procedura të tilla që grupet e vlerësimit të jashtëm të kenë brenda tyre dhe vlerësues ndërkombëtare. Të hartohen standarde, kritere e procedura vlerësimi si dhe të ndërmarrin projekte të përbashkëta vlerësimi për të rritur përputhshmërinë e aktiviteteve të vlerësimit të grupeve të ndryshme të vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit.

¹² I disponueshëm në: www.cepes.ro/hed/recogn/groups/transnat/code.htm

UDHËZIME PËR INSTITUCIONET/TRUPAT E NJOHJES AKADEMIKE

Konventat rajonale të UNESCO-s mbi njohjen dhe kualifikimet janë instrumenta të rëndësishme për lehtësimin dhe njohjeve të ndershme të kualifikimeve në Arsimin e Lartë, duke përfshirë vlerësimin e kualifikimeve të huaja që rezultojnë nga lëvizja ndërkufitare e studentëve, profesionistëve të kualifikuar dhe Arsimin e Lartë Ndërkufitar.

Por, për të lehtësuar proceset e paanshme të njohjes së kualifikimeve akademike dhe për t'i bërë këto sisteme më transparente dhe të krahasueshme, ndihet nevoja për të ndërtuar mbi iniciativat ekzistuese, veprime ndërkombëtare plotësuese.

Në këtë kontekst, rekomandohet që Trupat e Njohjes akademike:

- (a) të ngrenë dhe të mbajnë rrjete rajonale dhe ndërkombëtare që mund të shërbejnë si platforma për shkëmbimin e informacionit dhe praktikës së mirë, përhapjen e dijeve, rritjen e mirëkuptimit për zhvillimet dhe sfidat ndërkombëtare dhe përmirësimin e ekspertizës profesionale të stafit të tyre.
- (b) Të forcojnë bashkëpunimin e tyre me grupet e Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit për lehtësimin e procesit të përcaktimit nëse një kualifikim i plotëson standardet bazë të cilësisë, si edhe të përfshijë në bashkëpunimin dhe lidhjet Ndërkufitare edhe Trupat e Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit. Ky bashkëpunim duhet të vazhdojë si në nivele rajonale edhe ndër-rajonale.
- (c) Të vendosen dhe të mbahen kontaktet me të gjithë aktorët kryesorë për të ndarë informacion dhe përmirësuar lidhjet midis metodologjive për vlerësime akademike dhe profesionale.
- (d) Kur është e mundur, të adresohen njohjet profesionale të kualifikimeve në tregun e punës dhe të sigurohet informacioni i nevojshëm mbi njohjet profesionale, si për ata që kanë kualifikime të huaja ashtu dhe për punëdhënësit.

Duke parë rritjen e dukshme të tregjeve ndërkombëtarë të punës dhe rritjes së lëvizshmërisë profesionale, bashkëpunimit dhe koordinimit me shoqatat profesionale rekomandohet për këtë qëllim:

- (e) Të përdoren Kodet e praktikës së Mirë si Këshilli i Europës e UNESCO-s "Rekomandime mbi kriteret dhe procedurat për vlerësimin e kualifikimeve të huaja"¹³ dhe kode të tjerë të praktikës, për të rritur besimin e publikut në procedurat e njohjes, dhe të sigurohen aktorët e tjerë kyç që shqyrtimi i kërkesave kryhet në një mënyrë të pajtueshme dhe të paanshme.

- (f) Të sigurohet informacion i qartë, i saktë dhe lehtësisht i arritshëm mbi kriteret për vlerësimin e kualifikimeve, duke përfshirë edhe kualifikimet nga arsimi ndërkufitar.

¹³ I disponueshëm në: www.coe.int/T/DG4/HigherEducation/Recognition/Criteria%20and%20procedures_EN.asp#TopOfPage

UDHEZIME PER TRUPAT/GRUPET PROFESIONALE¹⁴

Sistemet e njohjeve profesionale ndryshojnë nga vendi në vend dhe nga profesioni në profesion. Psh: në disa raste, një kualifikim akademik i njohur mund të jetë i mjaftueshëm për hyrjen në praktikën profesionale, kurse në raste të tjera, vihen kërkesa shtesë mbi mbajtësit e kualifikimeve akademike për të hyrë në profesion. Duke parë rritjen e dukshme të tregjeve ndërkombëtare të punës dhe rritjes së lëvizshmërisë profesionale, mbajtësit e kualifikimeve akademike, si edhe punëdhënësit dhe shoqatat profesionale po përballojnë shumë sfida. Transparenca në rritje – domethënë, përmirësimi i disponueshmërisë dhe cilësisë së informacionit – është vendimtar për procese njohjeje të paanshme e të ndershme.

Në këtë kontekst, rekomandohet që grupet profesionale përgjegjëse për njohjen akademike:

- (a) të zhvillojnë rrugët e informacionit që janë të arritshme si për mbajtësit kombëtarë të kualifikimeve ashtu dhe për të huajt, që ti asistojnë ata në përfitimin e njohjes profesionale të kualifikimeve të tyre, si dhe punëdhënësit, të cilët kanë nevojë për këshillim mbi njohjen profesionale të kualifikimeve të huaja. Informacioni duhet të jetë gjithashtu lehtësisht i arritshëm për studentët aktualë e ata potencialë.
- (b) Për të përmirësuar metodologjitë e vlerësimit të kualifikimeve, të krijojnë dhe të mbajnë kontakte midis grupeve profesionale si të vendeve dërguese ashtu dhe pritëse, Institucioneve të Arsimit të Lartë/ofruesit, grupeve për Sigurimin e Cilësisë dhe Akreditim, si edhe trupave të njohjes akademike.
- (c) Të krijojnë, të zhvillojnë dhe të vënë në jetë kritere dhe procedura vlerësimi për krahasimin e programeve dhe kualifikimeve, për të lehtësuar kështu njohjen e kualifikimeve dhe të përshtatin rezultatet e të mësuarit dhe kompetencat që janë të përshtatshme në kontekstin kulturor, përveç kërkesave në hyrje dhe proces.
- (d) Të përmirësojnë disponibilitetin në nivel ndërkombëtar të informacioneve të përditësuar, të sakta dhe të përshtatshme mbi marrëveshjet reciproke/të dyanshme të njohjes për profesionet dhe të inkurajojnë zhvillimin e marrëveshjeve të reja.

¹⁴ Ky seksion i referohet institucioneve që kanë kompetencën ligjore në fushën e rregullimit të profesioneve dhe njohjen e profesioneve. Në disa vende, këto institucione janë grupe profesionale; në vende të tjera, ky rol përmbushet nga autoritete të tjera kompetente, psh grupet ministrore.